

V E N D I M
Nr.529, datë 21.8.1998

**PËR PROCEDURAT E TENDERIMIT TË PAKETAVE TË AKSIONEVE TË
SHOQËRIVE TREGTARE QË ZOTËROHEN NGA SHTETI**

Në mbështetje të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit" (ndryshuar me kate të tjera ligjore), paragrafit të dytë të nenit 3 të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 "Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë", me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Të përgjithshme

1. Privatizimi me tender i paketave të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave për privatizimin me tender të paketave të aksioneve duhet të përcaktojë formën e tenderit (të hapur ose të kufizuar), në rastin e tenderit të kufizuar edhe emrat e kandidatëve që ftohen për të marrë pjesë në tender.

3. Në rastin e tenderit të hapur të gjithë kandidatët e interesuar ftohen të paraqesin ofertat e tyre, ndërsa në tenderin e kufizuar paraqesin oferta vetëm kandidatët që ftohen direkt nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit. Kandidatët që marrin pjesë në tender duhet të jenë persona juridikë, vendas ose të huaj.

4. Procedurat e tenderit realizohen nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

5. Në një shoqëri tregtare të miratuar për privatizim me tender, nuk do t'i nënshtrohet tenderit, paketave të aksioneve për këto raste:

- në rastin e shitjes së paketave për publikun;
- në rastin e transferimit të paketës së aksioneve të ish-pronarëve të truallit;
- në rastin e këmbimit të aksioneve për punonjësit e shoqërisë tregtare.

Madhësia e këtyre paketave do të përcaktohet në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.446, datë 9.7.1998 "Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë", kapitulli I, pikat A, B dhe C.

II. Procedurat

1. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave, për privatizimin me tender të paketave të aksioneve, Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nxjerr urdhrin për përgatitjen e dokumentacionit të privatizimit me tender të shoqërisë, të përcaktimit të kriterëve dhe pikëve të vlerësimit të ofertave.

2. Dokumentacioni për privatizimin me tender përgatitet nga shoqëria tregtare që do të privatizohet dhe organi i varësisë administrative dhe dërgohet pranë Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Kjo e fundit, brenda 30 ditëve nga marrja e dokumentacionit, bën shqyrtimin e tij dhe e dërgon në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit.

3. Agjencia Kombëtare e Privatizimit do të garantojë barazinë e informacionit për të gjithë kandidatët e interesuar, si dhe do të sigurojë informacionin e nevojshëm për ta.

4. Dorëzimi dhe hapja bëhet përpara komisionit të vlerësimit të ofertave.

II.1 Ftesa për tender dhe njoftimi i tij

1. Ftesa për tender publikohet në dy gazeta me qarkullim kombëtar në 3 (tre) numra të njëpasnjëshëm, me afishe në zonën pranë vendndodhjes së shoqërisë tregtare, si dhe nëpërmjet letrës, telefaksit, teleteksit etj.

2. Në rastin e një ftese për tender të kufizuar, ftesa për tender dhe kërkesat e detajuara u dërgohen jo më pak se 3 (tre) kandidatëve.

3. Ftesa për tender u dërgohet kandidatëve jo më pak se 30 ditë përpara ditës së vendosur për paraqitjen e ofertave.

4. Ftesa për tender përmban:

- a) emërtimin e shoqërisë dhe vendndodhjen e saj;
- b) paketën e aksioneve të shoqërisë tregtare që privatizohet;
- c) formën e tenderit;
- d) formulën e plotë të privatizimit ose përcaktimin e paketave të veçanta të aksioneve të shoqërisë tregtare;
- e) vendimin dhe fatin për tërheqjen e dokumentacionit të tenderit;
- f) pagesën për tërheqjen e materialit informativ, në këmbim të një deklarate me shkrim për ruajtjen e konfidencialitetit për dokumentacionin e tërhequr nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit;
- g) vendin, mënyrën dhe datën e saktë për dorëzim dhe hapjen e ofertave;
- h) specifikime për garancinë e tenderit dhe përcaktimin e afatit përfundimtar të vlefshmërisë së ofertës.

5. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit i paraqet Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, në origjinal dhe sipas formës së kërkuar nga ligji, dokumentacionin që vijon:

- a) vendimin e Këshillit të Ministrave dhe urdhrin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit me tender të paketës së aksioneve të shoqërisë tregtare;
- b) vendimin e regjistrimit të shoqërisë tregtare në regjistrin tregtar;
- c) aktin e themelimit të shoqërisë tregtare;
- d) statutin e shoqërisë;
- e) bilancet për tre vjetët e fundit të aktivitetit të shoqërisë;
- f) vleftën e paketës së aksioneve të shoqërisë tregtare që ofrohet në tender;
- g) strukturën e pronësisë së shoqërisë tregtare;
- h) planin e rilevimit, planimetrinë dhe aktvlerësimin e truallit të shoqërisë tregtare;
- i) materialin informativ ose materialin përmbledhës me të dhënat kryesore të shoqërisë tregtare që privatizohet;
- j) përshkrimin e shoqërisë tregtare:
 - emrin e shoqërisë;
 - datën e krijimit;
 - sferën e aktivitetit;
 - kohën e veprimtarisë;
 - kontributin në kapitale dhe në ekuitete;
 - detyrimet debitore dhe kreditore të shoqërisë;
 - të dhënat për cilësinë e stafit mesatar;
 - një listë të pasurisë së paluajtshme në përdorim të shoqërisë;
 - personelin kryesor dhe të dhënat profesionale të stafit drejtues të shoqërisë;

k) përshkrimin e aktivitetit të shoqërisë së bashku me analizën dhe vlerësimin krahasues me pasqyrim të veçantë të informacionit në lidhje me prodhimin, shitjen, kërkimin, zhvillimin dhe investimet;

1) raportet e treguesve të fundit vjetor të shoqërisë si (bilanci, deklarata e të ardhurave etj.), sipas ekspertizës financiare të ekspertit kontabël të autorizuar;

m) paraqitja e detyrimeve tatimore nga autoritetet kompetente.

6. Brenda afatit të caktuar në ftesën e tenderit, kandidatët e interesuar, përkundrejt pagesës, mund të tërheqin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) plan për rilevim të pasurive të paluajtshme të shoqërisë tregtare të publikuar për shitje;

b) afatet dhe kushtet e shitjes, duke përfshirë aplikimin e metodave të pagesës dhe një sistem të mundshëm të kërkesave lidhur me politikën e biznesit, politikën e punësimit dhe zhvillimit, kushtet për mbrojtjen e mjedisit etj., garancitë e nevojshme dhe sanksionet në lidhje me detyrimet;

c) vendi ku drejtohen pyetjet në lidhje me tenderin dhe mundësitë për sigurimin e informacionit shtesë;

d) specifikime për garancinë e tenderit dhe përcaktimi i afatit përfundimtar të vlefshmërisë së ofertës;

e) bilancet për 3 vitet e fundit të aktivitetit të shoqërisë;

f) vlerën e paketës së aksioneve të shoqërisë tregtare që ofrohet në tender;

g) strukturën e pronësisë së shoqërisë tregtare;

h) materialin informativ përmbledhës me të dhënat kryesore të shoqërisë tregtare që privatizohet;

i) të dhënat për shitjen:

- madhësia e paketës për shitje;

- vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë;

j) procedurat e vlerësimit të dokumentacionit dhe kriteret përkatëse me konsiderata të veçanta për sa më poshtë:

- koha dhe vendi i hapjes së ofertave;

- përcaktimi i kohës për vlerësimin e ofertave;

- mënyra dhe vendi i shpalljes së rezultateve të tenderit;

k) lista përmbledhëse e dokumentacionit të ftesës për tender dhe anekset e saj.

III. Garantimi i tenderit

1. Kandidati për pjesëmarrjen në tender duhet të paraqesë:

a) Dokumentin bankar që vërteton ngrirjen, për periudhën deri në përfundim të tenderit të pagesës paraprake në lekë ose garanci bankare me 30 për qind të vlerës nominale të paketës së aksioneve të shoqërisë tregtare që ofrohet për tender, në datën dhe mënyrën e specifikuar në ftesën për tender. Kjo shumë ngrihet për llogari të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.

b) Vendimin e regjistrimit në regjistrin ose aktin publik që vërteton regjistrimin e tyre si të tillë në vendin e origjinës.

c) Dokumente referencash nga institucione bankare dhe financiare.

2. Kushti i garancisë së tenderit do të kthehet në rast se:

- ftesa për tender është anuluar;

- dokumentet e paraqitura për ofertë janë të pavlefshme;

- pjesëmarrësi nuk është fitues i tenderit;

- kontrata nuk është e përfunduar, për shkaqe për të cilat Agjencia Kombëtare e Privatizimit është përgjegjëse.

3. Kushti i garancisë së tenderit nuk do të kthehet në rast se:

- në pajtim me ftesën për tender ajo është transformuar në një siguri suplementare për garantimin e përfundimit të kontratës;

- anulohet nga kandidatët oferta e paraqitur në tender gjatë periudhës së vlerësimit të ofertave;

- kandidati është gjetur përgjegjës për moslidhjen e kontratës;

- kontrata nuk është përfunduar për çdo arsye që bie ndesh me interesat e kandidatëve të tjerë pjesëmarrës në tender.

4. Me kërkesën e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, kandidati është i detyruar ta paraqesë dokumentacionin përkatës për të vërtetuar cilësitë e tij të vendosura në ofertë.

IV. Paraqitja dhe vlefshmëria e ofertave

1. Në ditën dhe vendin e përcaktuar në ftesën për tender, kandidatët do të paraqesin ofertat e tyre (në 5 kopje) në zarf të mbyllur, të vulosura, pa emrin e kandidatit. Çdo faqe e 5 kopjeve të ofertës duhet të jetë me firmën origjinale të kandidatit (ose të autorizuarit prej tij).

Pjesëmarrja e kandidatëve në tender duhet të deklarohet pranë Agjencisë Kombëtare të Privatizimit jo më pak se 5 (pesë) ditë para dorëzimit dhe hapjes së ofertave.

2. Kandidati do të paraqesë vetëm një ofertë.

3. Ofertat e paraqitura në përgjigje të një ftese për tender do të përmbajnë deklaratën me anë të së cilës kandidati angazhohet për:

- pranimin e kushteve të përcaktuara në ftesën për tender;

- marrjen përsipër të detyrimeve dhe shërbimeve që rrjedhin nga pranimi;

- shumën për çmimin e ofruar ose alternativat e tij.

4. Dorëzimi dhe hapja e ofertave bëhet konform kërkesave të këtij vendimi dhe mbi këtë bazë vendoset për ofertat që janë të vlefshme për të vazhduar procedurën.

5. Pavarësisht nga vlefshmëria e ofertave dhe suksesi ose dështimi i tenderit, shpenzimet për përgatitjen e ofertave dhe për përfshirjen e kandidatit në tender, përballohen nga pjesëmarrësi në tender.

V. Konfidencialiteti

1. Deri në përfundim të kontratës së shitjes kandidati duhet të trajtojë në mënyrë konfidenciale përmbajtjen e ofertave sikurse edhe të gjitha faktet, informacionin dhe të dhënat e vëna në dispozicion të tij nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit në materialin informativ të detajuar ose nëpërmjet çdo kanali tjetër konfidencial. Ai do t'i japë informacion një pale të tretë.

Kjo nuk zbatohet lidhur me faktet e komunikuar bankare dhe në rastin e një oferte të përbashkët, për anëtarët e konsorciumit.

2. Agjencia Kombëtare e Privatizimit ka të drejtë të quajë ofertën e kandidatit përkatës të pavlefshme dhe ta anulojë atë, në qoftë se kandidati ose ndonjë person tjetër përfaqësues i tij dhunon konfidencialitetin lidhur me tenderin.

3. Agjencia Kombëtare e Privatizimit duhet të ruajë konfidencialitetin e përmbajtjes së ofertave deri në përfundimin e tenderit dhe të mos japë asnjë informacion lidhur me përmbajtjen e tij.

4. Agjencia Kombëtare e Privatizimit duhet të përdorë ofertat e paraqitura vetëm për vlerësim. Nëse ato do të duhen të përdoren për qëllim tjetër, të dy palët duhet të bëjnë një kontratë të veçantë.

VI. Dorëzimi dhe hapja e ofertave

1. Agjencia Kombëtare e Privatizimit i paraqet komisionit të vlerësimit të ofertave listën e kandidatëve që kanë njoftuar pjesëmarrjen në tender.

2. Ofertat dorëzohen dhe hapen në vendin dhe kohën e përcaktuar në ftesën për tender, para komisionit të vlerësimit të ofertave.

VII. Detyrat e komisionit të vlerësimit të ofertave

1. Komisioni i vlerësimit të ofertave krijohet 24 orë para datës së dorëzimit dhe hapjes së ofertave.

2. Komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga këta anëtarë:

- a) përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit;
- b) 2 përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit;
- c) 2 përfaqësues të organit të varësisë administrative;
- d) jurist i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit;
- e) sekretari (punonjës i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit).

Kryetari i komisionit të vlerësimit të ofertave është përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.

3. Komisioni i vlerësimit të ofertave shpërblehet 1 deri në 2 paga mujore, sipas përcaktimit të Kryetarit të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.

4. Nuk duhet të marrin pjesë në komisionin e vlerësimit të ofertave:

- a) një person, përfaqësues i ndonjë institucioni ose organizate të tyre, i cili është kandidat në tender;
- b) punëdhënës ose nëpunës të cilët kanë marrëdhënie kontraktore me shoqërinë;
- c) pronar i pjesshëm ose i vetëm, ose anëtar i një ndërmarrje ose biznesi ligjor që paraqitet si kandidat.

5. Çdo person, pjesëmarrës në komisionin e vlerësimit të ofertave duhet të japë deklaratë për lidhje gjaku, krushqie ose interesash me pjesëmarrësit në tender.

6. Anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të ruajnë konfidencialitetin. Kandidatët duhet të përdorin informacionin e kërkuar në cilësinë dhe të drejtën e mësipërme ekzkluzivisht për qëllim të vlerësimit të ofertave.

7. Agjencia Kombëtare e Privatizimit dy ditë para dorëzimit dhe hapjes së ofertave i kërkon Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe organit të varësisë administrative, emrat e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave.

VII. Vlerësimi i ofertave

1. Njëkohësisht me dorëzimin dhe hapjen e ofertave, komisioni i vlerësimit të ofertave mund të kërkojë informacion nga kandidatët në tender, me qëllim lehtësimin e vlerësimit dhe krahasimin e ofertave. Pyetjet dhe përgjigjet e dhëna nga kandidatët në tender që lidhen me to, duhet të mbahen të regjistruara me shkrim. Kjo nuk do të ndikojë në ndryshimin e kushteve të kërkesës së dorëzuar për tender, por vetëm kryesisht në interpretimin e tyre.

2. Komisioni i vlerësimit të ofertave bën vlerësimin e ofertave mbi bazën e përcaktimeve të urdhrit të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Vlerësimi bëhet si vijon:

Kandidati që, për një kriter të caktuar, jep shifrën më të mirë, do të marrë maksimumin e pikëve, ndërsa për të tjerët, llogaritja mund të bëhet mbi bazën e metodës proporcionale.

Pas llogaritjes së pikëve, për secilin kandidat bëhet renditja e tyre në mënyrë zbritëse, duke përcaktuar kandidatin më të mirë (ata që vlerësohen me numrin më të madh të pikëve).

3. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka këto detyra:

3.1. Të krahasojë ofertat në bazë të kriterëve dhe rëndësisë të specifikuara në ftesën për tender duke marrë në konsideratë dispozitat e këtij vendimi. Komisioni i vlerësimit, mund të kërkojë pjesëmarrjen e një eksperti për dhënien e një vlerësimi, i cili jep mundësinë për një vlerësim me një drejtim të caktuar të veçantë.

3.2 Pas vlerësimit të secilës ofertë komisioni i vlerësimit të ofertave harton një dokument argumentues për vlerësimin e bërë për ofertat. Ky dokument përmban:

- a) objektin e tenderit, paketën e aksioneve që nxirret për shitje;
- b) një përmbledhje të shkurtër të procedurës, numrin e ofertave të marra;
- c) një përmbledhje të ofertave të marra;
- d) kriterin kryesor të vlerësimit të ofertave dhe opinionin që shfaqet në lidhje me ofertat individuale;
- e) kriteret e përcaktimit të çmimit të blerjes;
- f) një vlerësim përmbledhës të rezultatit të procedurës së tenderit së bashku me renditjen e kandidatëve sipas vlerësimit të bërë për ofertat e tyre.

IX. Deklarimi i pavlefshmërisë së ofertës dhe suksesit të tenderit

1. Një ofertë duhet të deklarohet e pavlefshme, në qoftë se:

- a) kandidati në tender nuk ka plotësuar garancitë e nevojshme;
- b) kandidati në tender ka shkelur konfidencialitetin e tenderit;
- c) kandidati në tender ka dështuar kur bën një deklaratë të detajuar të legalizuar të ofertës së tij, që nuk përputhet me ofertën e paraqitur;
- d) kandidati në tender nuk ka plotësuar kushtet e ftesës për tender.

2. Tenderi deklarohet i pasuksesshëm, në qoftë se:

- asnjë nga ofertat e paraqitura nuk plotëson kërkesat e ftesës për tender;
- kërkesa të tjera përputhen me objektin e tenderit;
- Këshilli i Ministrave nuk miraton privatizimin e paketës.

X. Marrja e vendimit dhe njoftimi i rezultateve të tenderit.

1. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka autoritetin e vlerësimit të ofertave dhe nxjerrjes së rezultatit të tenderit.

2. Nëse nuk është përcaktuar ndryshe në ftesën për tender, ofertat duhen vlerësuar brenda 10 ditëve nga afati i dorëzimit dhe hapjes së ofertave. Për rastet e veçanta komisioni i vlerësimit të ofertave mund të zgjasë afatin e vlerësimit të ofertës edhe 5 ditë të tjera. Kjo u bëhet e njohur pjesëmarrësve në tender.

3. Në vendimin e rezultatit të tenderit duhen shënuar, me përjashtim të fituesit, edhe kandidatët e klasifikuar në tender në vend të dytë e të tretë, me të cilët AKP-ja mund dhe duhet të përfundojë një kontratë, në rast se kontrata me fituesin dështon ose në qoftë se fituesi nuk plotëson kontratën.

4. AKP-ja duhet të komunikojë rezultatin e tenderit tek të gjithë kandidatët, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vlerësimit të ofertave.

5. AKP-ja brenda 7 ditëve, nga përfundimi i tenderit dhe nxjerrjes së rezultateve, përgatit projektvendimin dhe relacionin përkatës së bashku me gjithë dokumentacionin e plotë të tenderit dhe ia paraqet për shqyrtim e miratim Këshillit të Ministrave.

XI. Mbyllja e kontratës

1. Vetëm pasi Këshilli i Ministrave miraton procedurën e tenderimit dhe vendos për privatizimin e paketës së aksioneve, Agjencia Kombëtare e Privatizimit lidh kontratën me kandidatin fitues.

2. Elemente të kontratës për shitjen e pronës janë të gjitha kërkesat e vendosura në ftesën për tender dhe penalitetet përkatëse.

3. Kontrata duhet përfunduar brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave.

4. Nëse kontrata:

- a) dështon së qeni e zbatueshme;
- b) pas nënshkrimit të kontratës fituesi dështon në plotësimin e saj dhe për këto arsye AKP-ja i jep fund kontratës;
- c) palët bien dakord t'i japin fund kontratës;
- d) AKP-ja duhet të përfundojë një kontratë me ofruesin tjetër sipas radhës së klasifikimit me pikë.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit të nxjerrin udhëzimin përkatës për realizimin e procedurave të tenderit për shitje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano